



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 78, datë 29.03.2021

PËR PRANIMIN E ANKIMIT

Në mbështetje të nenit 3, 4 dhe 49 të ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 113, pika 3 të “Kodit të Procedurave Administrative” dhe nenit 189 të Ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 24 dhe 27 të “Kodit të Procedurës Penale”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë pasi u njoh me ankesën e z. Dritan Marku, prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, kundër vendimit të Drejtuesit të Prokurorisë “Mbi zëvendësimin e prokurorit” të datës 17.03.2021, paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nëpërmjet kërkesës së regjistruar me nr.803 prot datë 23.03.2021, bazuar në relacionin e paraqitur për shqyrtim nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe i Buxhetit,

V E N D O S I:

1. Pranimin e ankimit të z. Dritan Marku në lidhje me Vendimin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë “Mbi zëvendësimin e prokurorit” të datës 17.03.2021.
2. Shfuqizimin e vendimit të Drejtuesit të Prokurorisë “Mbi zëvendësimin e prokurorit” të datës 17.03.2021.
3. Relacioni shoqërues është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Të njoftohet për këtë vendim z. Dritan Marku dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI



ANËTAR
VATË STAKAJ




ANËTAR
SANDËR BECI



ANËTAR
TARTAR BAZAJ



ANËTAR
ELOIDA GOXHI



ANËTAR
ESMERALDA KESHI



ANËTAR
MOISI DUDA

